

Zyrës për Doktoraturë të Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më 30.10.2025 solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **"ASPEKTET SOCIALE NË "TRILOGJINË E KAJROS" TË NEXHIB MAHFUDHIT"** të kandidatit **Mr. Bekim Sulejmani**.

Në bazë të vendimit 16-1032/2 të datës 30.10.2025, Komisioni i përbërë nga: Prof.dr. Ziber Lata, (kryetar), Prof.dr. Sulejman Baki, Prof.dr. Salajdin Salu, Prof.dr. Zejni Mazllami (anëtarë) dhe Prof.dr. Adnan Ismaili (mentor), pasi analizoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

1. Të dhënat biografike për kandidatin

Kandidati Mr. Bekim Sulejmani është lindur më 18 nëntor të vitit 1977 në Tetovë, ku ka kryer shkollimin fillor. Shkollën e mesme e ka kryer në Medresenë "Isa Beu"- Shkup. Gjatë viteve 1998-2000 me sukses ka kryer kursin e avancuar të gjuhës arabe. Studimet deridiplomike ku ka kryer në Universitetin al-Imam Muhamed bin Saud- Riad (Arabia Saudite), në Fakultetin e Thirrjes islame dhe komunikimit masiv (2000-2005).

Në vitin akademik 2013/2014 ka regjistruar ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale, të cilat i ka përfunduar në mars të vitit 2019, me temë të magjistraturës: *"Ibn Mukafa- jeta dhe vepra"*. Në vitin akademik 2020/2021 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale.

Nga viti 2003 është përkthyes gjyqësor për gjuhët arabisht-shqip-arabisht dhe arabisht-maqedonisht-arabisht në rajonin e Gjykatës së Tetovës. Gjatë viteve 2011-2023 ka punuar si mësimdhenës. Nga viti akademik 2018/2019, kandidati Mr. Bekim Sulejmani ka qënë i angazhuar si asistent i jashtëm në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale.

Nga viti 2023 është i punësuar si asistent me orar të plotë në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale për lëndët *Letërsi arabe*, fushë në të cilën është edhe ky disertacion i doktoraturës.

2. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës

Kandidati Mr. Bekim Sulejmani që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime shkencore në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore.

Nga punimet e botuara gjatë kësaj periudhe kemi veçuar:

- *The Views of Ibn al-Muqaffa on Morality and Power in the Works "Al'Adab es-saghir" and "Al-Adab al-Kabir"*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 5, Issue 1, 2025.
- *Naguib Mahfouz – The Voice of Social Conscience in Modern Arabic Literature*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 5, Issue 6, 2025.

3. Analizë e disertacionit të doktoraturës

Disertacioni i doktoraturës me titull: **"ASPEKTET SOCIALE NË "TRILOGJINË E KAJROS" TË NEXHIB MAHFUDHIT"** i kandidatit **Mr. Bekim Sulejmani** përbëhet nga Hyrja, gjashtë kapituj, Përfundimi dhe Rekomandim si dhe Bibliografia.

Në Hyrje, kandidati e diskuton metodologjinë hulumtuese gjatë punimit të disertacionit duke dhënë një pasqyrë të gjerë edhe të punimeve dhe studimeve ndërkombëtare në

Në **Kapitullin e parë, JETA, VEPRJA DHE PERSONALITETI LETRAR I NEXHIB MAHFUDHIT**, është ndarë në tre nëntituj: *Jeta dhe vepra; Personaliteti letrar; Ndikimi i Mahfudhit në letërsinë bashkëkohore arabe dhe botërore.*

Nexhib Mahfudhi romancier dhe shkrimtar egjiptian, është njëri nga figurat me të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore arabe, fitues i çmimit Nobel për letërsi. Vepra e tij përbën një pasqyrë të thellë të transformimeve shoqërore në Egjiptin e shekullit XX, duke u shndërruar në simbol të ndërthurjes mes realitetit, historisë dhe filozofisë.

Letërsia bashkëkohore, nëpër shekullin XX, përjetoi një transformim të thellë tematik dhe stilistik. Në këtë kontekst, Nexhib Mahfudh shquhet si zëri më përfaqësues i një brezi që u përball me përplasjen mes traditës, realitetit kolonial dhe modernizimit shoqëror. Si një letrar i madh, Mahfudhi nuk u mjaftua me ndërtimin estetik të veprës, por përdori fjalën si mjet për të ngritur çështje të drejtësisë, lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

Guximi për të përballuar frikën, për të sfiduar "status quo-në" dhe për të kërkuar drejtësinë, nuk është një akt heroizmi i jashtëm, por një luftë e vazhdueshme brenda vetes. Fitorja më e rëndësishme, sipas Mahfudhit, është ajo ndaj vetvetes, ndaj dobësive, egoizmit dhe indiferencës që pengojnë realizimin e një shoqërie më të drejtë dhe më humane. Drejtësia, nuk është një dhuratë e rastësishme, por një qëllim për të cilin duhet të punohet pandërprerë, duke u përballur me sfida, duke sakrifikuar dhe duke ruajtur shpresën edhe kur gjithçka duket e errët.

Në **Kapitullin e dytë**, *TRILOGJIA NË LETËRSI DHE TRILOGJIA E KAJROS E NEXHIB MAHFUDHIT*, është ndarë në tre nëntituj: *Nocioni dhe koncepti i trilogjisë në letërsi; Vendëzënia e Trilogjisë së Kajros në letërsinë bashkëkohore arabe; Ndikimet e Trilogjisë së Kajros në letërsinë bashkëkohore arabe.*

Trilogjia në letërsinë moderne është një formë narrative e cila mund të shihet si një histori e lidhur ngushtë me ngjarjet që përshkruajnë një zhvillim dramatik të shoqërisë dhe individëve. Me nocionin trilogji nënkuptojmë tri vepra të një autori, që kanë lidhje e përbëjnë një tërësi. Trilogjia në letërsinë moderne ka marrë një zhvillim të gjerë dhe të thellë, duke u përdorur nga shumë shkrimtarë për të ndërtuar tregime të ndërlukuara dhe për të trajtuar tema të ndryshme që lidhen me individin dhe shoqërinë. Përdorimi i trilogjisë në letërsinë moderne ofron mundësinë e zhvillimit të thellë të personazheve, përshkrimit të periudhave të gjata kohore dhe hetimit të konflikteve sociale, politike dhe filozofike.

"*Trilogjia e Kajros*" në letërsinë arabe është një nga momentet më të rëndësishme në historinë të letërsisë moderne arabe. Kjo trilogji, që është një nga veprat më të njohura të Nexhib Mahfudhit, ka fituar vlerësime të mëdha dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në shqyrtimin e shoqërisë dhe politikës egjiptiane gjatë periudhës mes dy luftërave botërore.

"*Trilogjia e Kajros*", me tre pjesët e saja, pasqyron shoqërinë egjiptiane dhe përfshinë tri periudha kohore: Romani "*Bejne el-kasrejn*" (1956), përfshinë periudhën 1917-1919; romani "*Kasr el-sheuk*" (1957), pasqyron ngjarjet e viteve 1924-1927 dhe romani "*es-Sukerije*" (1957), trajton jetën e shoqërisë egjiptiane mes viteve 1935-1944, ndër me voluminozet me mbi 1500 faqe ku çdo pjesë e mban emrin sipas rrugëve afër xhamisë së madhe të Huseinit në lagjen e njëjtë të Kajros.

Në Kapitullin e tretë, *NEXHIB MAHFUDHI SI RREFENJES, DËSHMITAR I RRETHANAVE SHOQËRORE NË EGJIPT DHE KRITIK*, është ndarë në tre nëntituj: *Analizë e temave sociale dhe përmasa letrare e romanit بين القصرين (Mes dy pallateve)*; *Analizë e temave sociale dhe përmasa letrare e romanit قصر الشوق (Pallati i mallëngjimit)*; *Analizë e temave sociale dhe përmasa letrare e romanit السكرية (Sheqerja)*.

Romani "*Bejn el kasrejn*" (*Mes dy pallateve*) 1956: Titulli i romanit është emërtim i një rruge të vjetër të Kajros, në të cilën zhvillohen ngjarjet e revolucionit egjiptian të vitit 1919. Pra, romani paraqet periudhën historike të viteve 1917-1919, periudhë që shënon humbjen e gjermanëve në Luftën e Parë Botërore dhe tërheqjen e forcave australiane nga Egjipti. Kjo periudhë përfshinë jetën e shoqërisë egjiptiane nën protektoratin britanik, e cila do të rezultojë me revoltën popullore dhe me fillimin e lëvizjes popullore për shpalljen e pavarësisë së Egjiptit dhe dëbimin e britanikëve nga trualli egjiptian. Ky përshkallëzim i pakënaqësive do të kurorëzohet me revolucionin e vitit 1919. Mahfudhi pasqyron ngjarjet e përditshme dhe përpjekjet e familjes së Ahmed Abdul Xhevadit, e cila simbolizon modelin e shoqërisë egjiptiane. Shoqërinë e simbolizon lagjja, lagjen e simbolizon familja, e cila ofron një vizion të qartë mbi ngjarjet e përditshme, politike, sociale dhe mbi rrjedhën e revolucionit.

Romani "*Kasru esh-shauk*" (*Pallati i Mallëngjimit*) 1957: Romani morri emrin nga një zonë e vjetër në lagjen El- Xhemailje. Disa rrugë të zonës janë të mbyllura, disa janë të shkujdesura dhe disa të tjera janë të sistemuara dhe të organizuara – gjë që tregon se zona ka qenë dikur një pallat historik, i cili është vendi i ëndrrave, pasioneve, dëshirave të fshehta dhe zhgënjimeve. Me një mjeshtëri të rrallë, Mahfudhi ndërthur fatin e një familjeje me zhvillimet sociale, politike dhe kulturore të Egjiptit pas Revolucionit të 1919-ës, rreth viteve 1924–1927. një shoqëri në tranzicion midis traditës dhe modernitetit, nën ndikimin e kolonializmit britanik.

Në faqet e romanit "*Es-sukerijetu*" (*Sheqerja*) 1957: nuk përshkruhen vetëm ngjarjet dhe jeta e një lagjeje popullore, por ndërtohet një metaforë e vetë Egjiptit, me kontrastet dhe tensionet e tij të brendshme. Ky roman shënon kulmin e projektit letrar të Mahfudhit. Autori nuk sjell vetëm një histori familjare të fisit të Ahmed Abdulxhevadit, por ofron një tablo të gjerë të jetës politike, sociale dhe ideologjike të Egjiptit të asaj kohe. Kështu, përmes tij paraqitet një fotografi e gjallë e shoqërisë egjiptiane në një periudhë të trazuar të transformimeve shoqërore dhe zhvillimeve politike e historike ndërmjet viteve 1935–1944.

Në Kapitullin e katërt, *KARAKTERISTIKAT TIPOLOGJIKE TË PERSONAZHEVE NË "TRILOGJINË E KAJROS"*, është ndarë në katër nëntituj: *Ahmed Abdulxhevad*; *Emineja*; *Personazhet tjerë dytësorë*. Kandidati ka bërë një përshkrim të personazheve në këtë formë:

1. Ahmed Abudxhevadi, përfaqësues i autoritetit patriarkal. Pas vdekjes së djalit, bëhet më i tërhequr, por rikthehet më pas në dëshirat e tij të vjetra. Shpreh kontrastin mes autoritetit brenda familjes dhe jetës së lirshme jashtë saj;
2. Emineja, grua tradicionale, e përkushtuar, që simbolizon sakrificën e nënën së dhënë pas familjes, mbetet e mbyllur në dhimbjen për të birin;
3. Fehmiu, biri i Abdul Xhevadit, përfaqëson të riun egjiptian, i cili me stoicizëm dhe sakrificë thyen kufijtë dhe ndalesat e mendësisë së kaluar, për të fituar lirinë dhe për ta çliruar vendin;
4. Kemali, djali më i vogël, intelektual në zhvillim, që përfaqëson brezin e ri. Jeton një krizë identiteti mes traditës, dashurisë së zhgënjyer dhe filozofisë; Jasini, djali nga martesë e parë e Ahmedit, impulsiv, hedonist, që përfaqëson tipin e mashkullit që ndjek epshet pa menduar për pasojat;
5. Zenebja, grua e re, e shkathët dhe e pavarur. Përfaqëson një grua që sfidon normat shoqërore dhe përfiton nga burrat për të ndërtuar jetën që dëshiron;
6. Aida, e dashura e Kemalit, përfaqëson klasën e lartë aristokrate dhe refuzimin që vjen nga diferencat shoqërore. Është simbol i dashurisë së pamundur;
7. Zubejda, shndërrohet në zonjë, ndërsa burri i nënshtruar dorëzohet plotësisht ndaj kërkesave dhe dëshirave të saj. Ai përpiqet me çdo mënyrë t'ia plotësojë qejfet e saj;
8. Ummu Hanefi është grua e varfër, e cila, për shkak të nevojës së madhe për mbijetesë ekonomike, detyrohet të punojë si shërbyese në familjen e Ahmed Abdul Xhevadit, ku gëzon respekt dhe vlerësim, ndonëse në fund përkushtimi i saj nepërkëmbet.

Në **Kapitullin e pestë**, **TEMA SOCIALE NË "TRILOGJINË E KAJROS"**, është thelbi i këtij punimi, e ndarë ndarë në tetë nëntituj: *Shoqëria egjiptase në pasqyrën e Mahfudhit; Përplekjet për transformim shoqëror; Liria fetare dhe demokratizimi i shoqërisë; Imazhi i femrës në trilogjinë e Kajros; Kriza morale dhe sfidat e botëvështrimit të ri; Raporti i shoqërisë me ploitikën dhe shtetin; "Lufta mes brezave"; Ndarjet shtresore në shoqërinë e Egjiptit dhe mosmarrëveshjet sociale mes tyre.*

Në *"Trilogjinë e Kajros"*, Mahfudhi paraqet një përshkrim të saktë të shoqërisë egjiptiane dhe ndryshimeve të saj sociale. Ai është një nga të parët që i kushtoi vëmendje këtij realiteti historik, duke i përshkruar marrëdhëniet shoqërore me mënyra të ndryshme që shprehnin përmbajtjen e tyre të brendshme.

Në *"Trilogjinë e Kajros"*, Mahfudhi ngre një pasqyrë të gjerë sociale dhe politike përmes përshkrimit të familjes së Ahmed Abdulxhevadit dhe fatit të saj brez pas brezi. Në romanin *"Befne el-kasrefn"* shfaqet figura e fuqishme e Ahmedit, simbol i autoritetit patriarkal.

Ndërkaq, në pjesën e dytë të trilogjisë "*Kasru esh-Shauk*" fryn era e lirisë dhe e ndryshimeve të mëdha; shoqëria fillon kalimin nga ndriçimi me gaz, në dritën elektrike, një shenjë e qartë e modernizimit dhe e hyrjes në një epokë të re. Në romanin "*Es-Sukerijetu*" ngrihet një brez i ri, i cili dallohet për përkatësitë e ndryshme ideologjike dhe politike. Mahfudhi vendos në qendër të vëmendjes brezin e nipërve të Ahmedit.

Kjo vepër letrare është më shumë se një rrëfim. Ajo nuk e sheh jetën thjesht nga larg, por e jeton nga brenda, mes dimensioneve shoqërore, problemeve ekonomike, përplasjeve ideologjike e politike, pranishmërisë së pakicave kombëtare, varfërisë dhe mjerimit, papunësisë, nepotizmit, migrimit, martesës, divorcit, traditës dhe modernizimit.

Autori përshkruan se si populli vuante nga shtypja kolonialiste dhe padrejtësitë shoqërore, ku mjerimi i klasave të varfra përplasej me luksin e pallateve dhe shfrenimin e elitës. Mahfudhi paraqet me mjeshtëri kontrastin mes realitetit të jashtëm dhe trazirave të brendshme të shoqërisë. Analizimi i fragmenteve nga romani "*Es-sukerijetu*" tregon se çështja e migrimit nuk paraqitet vetëm si një lëvizje fizike nga një vend në tjetrin, por si një proces i thellë shoqëror, ekonomik dhe shpirtëror, që prek strukturën e familjes dhe të shoqërisë egjiptiane në gjysmën e parë të shekullit XX. Mahfudhi është pjesë përbërëse e ambientit social dhe kulturor. Ai, përmes lirisë së shprehjes, pasqyron diversitetin kulturor dhe ideologjik të shoqërisë egjiptiane.

Në "*Trilogjinë e Kajros*", ndërthuret edhe ilustrimi artistik, i cili arrin të shpalos imazhin politik, kulturor, fetarë e letrar të shoqërisë egjiptiane. Mahfudhi e paraqet këtë si një luftë të brendshme, që jeton si brenda familjes, ashtu edhe në zemrën e kombit: një brez i ndarë mes fesë, komunizmit, revolucionit, traditës dhe modernizmit.

Në **Kapitullin e gjashtë, KRAHASIMI I "TRILOGJISË SË KAJROS" ME LETËRSINË SHQIPE**, ka vetëm në nëntitull: *Analizë letrare dhe krahasim i veprave të Nexhib Mahfudhit me romanet e kësaj periudhe në letërsinë shqiptare*, ku janë marrë për krahasim trilogjitë e tre autorëve bashkëkohor shqiptar: Ismail Kadare, Sabri Godo dhe Rexhep Qosja.

Trilogjia e Luftës e autorit Ismail Kadare, veprat *Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur*; *Kronikë në Guri*; *Dimri i Madh*, që merren si pjesë e një cikli që trajton Luftën e Dytë Botërore dhe ndikimin e saj në shoqërinë shqiptare, të cilat krijojnë një pasqyrë të dramës historike të Shqipërisë; *Trilogjia Historike* e autorit Sabri Godo, ku bëjnë pjesë romanet historike: *Ali Pashë Tepelena*; *Skënderbeu*; *Prova e zjarrit*, të cilat ndërtojnë një fotografi historike të Shqipërisë nga periudha osmane deri në kohën e Skënderbeut; *Trilogjia e Lëngatës* e autorit Rexhep Qosja, një trilogji e drejtpërdrejtë dhe shumë e rëndësishme për letërsinë shqipe, ku bëjnë pjesë veprat: *Vdekja më vjen prej syve të tillë*; *Bijtë e askujt*; *Të fshehtat e treguaru*.

Në **Përfundim**, kandidati ka dhënë një përmbledhje të shkurtër dhe përmbajtësore, duke paraqitur rezultate dhe vlerësime mbi aspektet sociale të tre veprave që përbejnë Trilogjinë e Kajros. Kandidati ka nxjerr si përfundim se, prezantimi i veprës letrare të Mahfudhit në gjuhën shqipe ka rëndësi të madhe jo vetëm letrare, por edhe ideore e kulturore.

Në pjesën e **Bibliografisë/ Literaturës së shfrytëzuar** janë rradhitur në bazë të rendit alfabetik të gjitha burimet dhe literatura e konsultuar nga ana e kandidatit. Për hartimin e temës kandidati ka shfrytëzuar kryesisht burimet autoriale të autorit, studime dhe kritika letrare për Nexhib Mahfudhin dhe "*Trilogjinë e Kajros*", vepra shkencore të botuara, monografi, enciklopedikë, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën arabe.

4. Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull "**ASPEKTET SOCIALE NË "TRILOGJINË E KAJROS" TË NEXHIB MAHFUDHIT**", kandidati është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si, përshkrimi, analiza, krahasimi dhe kritikizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëra-tjetrën.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht burimet autoriale të autorit, vepra shkencore të botuara, monografi, zëra enciklopedikë, punime shkencore nga revista të ndryshme, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën arabe. Përshkrimet, analizat, krahasimet dhe kritikët janë bërë në bazë të metodologjisë së mirëfilltë shkencore dhe si rrjedhojë mund të shërbejnë si një bazë e mire për studimet e ardhshme.

Për shkak të natyrës së punimit metoda përshkuese ka gjetur më shumë përdorim. Fillimisht janë përshkruar në formë koncize tri romanet që përbejnë Trilogjinë e Kajros dhe nga të njëtat janë për zgjedhur aspektet sociale, të cilat i janë shtruar kritikës, apo thenë më saktë metodës së kritikizmit. Punimi ka synuar dhe me sukses ka arritur që tju jap përgjigje pyetjeve kërkimore rreth aspekteve sociale.

Kandidati pasi njeh gjuhën arabe në nivel akademik, kjo i ka ndihmuar që të shfletoj dhe shfrytëzoj burime relevante, si recensione, kritika letrar. Një meritë tjetër e kandidatit është shfrytëzimi i metodës krahasuese me theks të veçantë në kapitullin e fundit duke bërë krahasimin e Trilogjisë së Kajros me trilogjitë e autorëve shqiptarë (Kadare, Godo, Qosja), në fillim jep versionet e dy palëve pastaj bënë analizën krahasuese duke ia struar edhe një kritikë modeste letrare që paraqet këndvështrimin e vetë kandidatit.

5. Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Rezultatet kryesore të disertacionit të doktoraturës me titull: **"ASPEKTET SOCIALE NË "TRILOGJINË E KAJROS" TË NEXHIB MAHFUDHIT"**, mund të rezimohen si më poshtë:

- I. Nexhib Mahfudh përfaqëson një letërsi të angazhuar, të thellë dhe humaniste. Ai është një model i shkrimtarit që përmes artit ngre zërin për drejtësi, emancipim dhe ndërtim të shoqërisë mbi baza humane dhe etike. Trashëgimia e tij vazhdon të frymëzojë gjenerata të tëra, duke mbetur një zë i fuqishëm i ndërgjegjes universale dhe një pikë referimi për letërsinë botërore. Mahfudh na mëson se letërsia nuk është vetëm një pasqyrë e realitetit, por një forcë që e tejkalon atë, duke ndriçuar shtigje të reja të kuptimit dhe të vetëdijes.
- II. Për Mahfudhin, rrëfimi është një akt ekzistencial, një mundësi për të dëshmuar të vërtetën e brendshme dhe për të ruajtur dinjitetin e njeriut përballë padrejtësisë dhe absurditetit të botës. Në konceptin e Mahfudhit, Karjo nuk është një përkatësi gjeografike, por një personazh më vete, një organizim i gjallë, i përbërë nga rrugë të ngushta, kafene të zhurmshme dhe ndërtesa të rrënuara që bartin kujtimet e epokave të ndryshme. Ai shndërron hapësirat urbane në metafora të lirisë dhe robërisë, të kujtesës dhe harresës. Rrugicat e tij janë simbole të rrugëtimit të brendshëm të njeriut, ku secila kthesë përfaqëson një zgjedhje morale dhe filozofike.
- III. Pavarësisht madhështisë së artit të tij, Mahfudh nuk i shpëtoi anatemes. Disa shkrime të tij u cilësuan si blasfemi dhe u ndaluan në Egjipt, duke e kthyer autorin në një figurë polemike. Ky anatemim nuk ishte vetëm një gjykim fetar apo politik. Mahfudhi, përmes pasqyrit të konfliktit të individit me shoqërinë, i afrohet vizionit të autorëve të mëdhenj evropianë për njeriun si qenie e lirë dhe përgjegjëse.

6. Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Jetëpërshkrimi dhe veprimtaria letrare e Nexhib Mahfudhit ka qenë objekt studimi i shumë autorëve dhe kritikëve letrarë. Në gjuhën arabe është studiuar kjo temë në dhjetra e qindra artikuj, libra apo teza shkencore, ndonëse më pak edhe në gjuhët evropiane kemi studime, por në hapësirën ballkanike nuk ka ndonjë studim të veçantë dhe duke qenë ky studim i pari dhe ndoshta i vetmi fiton një rendësi të veçantë.

Vlerësojmë se prezantimi i veprimtarisë letrare të Mahfudhit në gjuhën shqipe është një kontribut i çmuar për njohjen e letërsisë bashkëkohore arabe. Ky prezantim ka rëndësi jo vetëm letrare, por edhe ideore e kulturore, pasi që lexuesi shqiptar nuk është i njohur me rrethanat dhe karakteristikat e popullit egjiptian ndërmjet dy luftërave botërore. Natyrisht, Mahfudhi si i vetmi letrar arab që ka fituar çmimin Nobel për letërsi ka zgjuar interesin e lexuesve për ta njohur më thellësisht dhe hollësisht krijimtarinë letrare të tij.

Trilogjia e Mahfudhit është një nga veprat më të rëndësishme në letërsinë arabe për shkak të përshkrimit të tij të pasur të jetës dhe realitetit egjiptian gjatë periudhës koloniale dhe të luftës për pavarësi. Nëpërmjet kësaj trilogjie, Mahfudhi trajton përçarjet sociale në Egjipt, duke treguar konfliktin midis gjeneratave, klasave shoqërore, dhe ndryshimeve kulturore dhe ekonomike që po ndodhin në shoqëri. Kjo përfshin përpjekjet për të balancuar traditën dhe modernitetin. Personazhet e romanit përballen me sfida të mëdha ekonomike, ndryshime kulturore, dhe përpjekje për ndryshim që reflektojnë ndryshimet më të mëdha të kohës. Personazhet e trilogjisë nuk janë thjesht individë, por janë gjithashtu simbolikë për grupet dhe shtresat sociale të shoqërisë.

7. Hulumtime të mundshme të ardhshme

Disertacioni i doktoraturës “**ASPEKTET SOCIALE NË “TRILOGJINË E KAJROS” TË NEXHIB MAHFUDHIT**”, është temë specifike dhe brenda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.

Duke marrë parasysh që problematika e trajtuar në këtë punim përqendrohet në temat sociale të shoqërisë egjiptase të pasqyruara në *Trilogjinë e Kajros* të Nexhib Mahfudhit, duhet theksuar se kjo fushë përbën një hapësirë të gjerë dhe thellësisht multidimensional. Për shkak të natyrës komplekse dhe të ndërthurur të fenomeneve sociale, ky studim nuk ka mundur që ti trajtojë në mënyrë të gjithanshme të gjitha segmentet e jetës shoqërore egjiptase.


Ky punim i doktoraturës hap stigje të reja për studimin e jetës, veprës dhe personalitetit letrar të Nexhib Mahfudhit, pasi për këtë temë përkatësisht aspekte të ndryshme kanë shkruar shumë autorë. Në të ardhmen mund të studiohen aspektet e përditshmerisë në veprat e Nexhib Mahfudhit.

Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për afrimin dhe njohjen e autorëve të letërsisë arabe me lexuesit shqiptar. Ky punim analizon dhe jep pasqyrë të shkurtër vetëm për aspektet sociale, por ka mundur që të jepte një tablo të përgjithshme dhe ky kufizim krijon mundësi që në të ardhmen të hartohen punime të ngjashme për studimin e çështjeve tjera.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni Recenzues për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës ***“ASPEKTET SOCIALE NË “TRILOGJINË E KAJROS” TË NEXHIB MAHFUDHIT*** të kandidatit Mr. Bekim Sulejmani, në përbërjen e mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij Raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni Recenzues:

1. Prof. Dr. Ziber Lata (Kryetar) 
2. Prof.dr. Sulejman Baki (anëtar) 
3. Prof.dr. Salajdin Saliu (anëtar) 
4. Prof.dr. Zejni Mazllami (anëtar) 
5. Prof.dr. Adnan Ismaili (anëtar) 

Tetovë, nëntor, 2025